



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:065691

Datë: 07.11.2019

Numri i dokumentit: 00632422

**P.nr.517/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve E Sh nga P Rr.”N K” pa nr. dhe A K nga P Rr.”V D” nr.51, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2872-6/18, të datës 19.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Pokurorit të Shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarve, me datë 29.10.2019 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datën 05.11.2019 e përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**E Sh**, nga i ati S dhe e ëma N Sh e vajzërisë B, i lindur me 16.05.2000, në P Rr.”N K pa numër, ku edhe tani jeton, me numër personal -----, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë vepër penale.

**A K**, nga i ati A dhe e ëma A K e vajzërisë B, i lindur me 04.01.2000, në P Rr.”V D” nr.51, ku edhe tani jeton, me numër personal-----, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë vepër penale.

**JANË FAJTOR**

**Se të akuzuarit:**

Me dt. 03.11.2018, në orët pas mesnatës, rreth orës 02:45 min. në S, në rrugën "G", të cilët në bashkëkryerje me të miturin H L, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, kryejnë vjedhjen nga marketi "A M", pronar i së cilës është i dëmtuari F H, në atë mënyrë që duke shfrytëzuar orët pas mesnatës, ku nuk ka frekuentim të qytetarëve, pas planifikimit paraprak në mes tyre, me automjetin "R M" ngjyrë e kaltër me targa regjistrimi ...-....-GJ, të cilën e marrin në renta car, shkojnë në S dhe duke vepruar me forcë, me një kaqavidë e hapin derën hyrëse të marketit, hyjnë brenda, dhe nga arka vjedhin shumën prej 91 €, dhe një sasi të pakove me cigare të llojeve të ndryshme dhe duke u larguar nga vendi i ngjarjes, zihen nga ana e policisë, derisa i pandehuri E Sh arrin t'i shmanget policisë.

Me çka kanë kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarve i'u shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit **E Sh dënimin me burg prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit **A K dënimin me burg prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

### **DËNIM PLOTËSUES**

Konfiskohet një (1) thikë me dorëz të zezë me gjatësi rreth 25 cm si dhe dy kaçavida me dorëz të zezë dhe të portokallt dhe me dorëz të zezë me të verdhë.

Obligohen të akuzuarit që në emër të kompenzimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro secili veç e veç, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Fetah Hoti, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2872-6/18, të datës 19.11.2018 kundër të akuzuarve ESh nga P Rr."N K" pa nr. dhe A K nga PRr."V D" nr.51, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Musli Gashi, të akuzuarit kanë theksuar se e kanë kuptuar në tërësi akuzën dhe e kanë pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga pranimi i fajësisë së të akuzuarve, nga shikimi dhe leximi i kallëximit penal nr.2018-GB-749 të dt.03.11.2018, shikimi dhe leximi në deklaratën e të pandehurit A K të dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren me dt.15.11.2018, në deklaratën e të pandehurit E Sh të dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren me dt.19.11.2019, në deklaratën e të dëmtuarit F H të dhënë në stacionin policor në Suharekë me dt.03.11.2019, fotodokumentacionin si dhe shkresave tjera të lëndës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe

dëmtimin e të mirës së mbrojtur sepse vepra është kryer duke kaluar apo depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura dhe duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme duke vepruar në atë mënyrë që me forcë përmes një kaçavide e hapin derën hyrëse të marketit dhe kanë depërtuar në hapësirën e mbyllur ku kanë kryer vjedhjen e përshkruar si në aktakuzë.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e mëparshme dhe rrethanat personale të të akuzuarve të cilët kanë qenë të padënuar më parë për ndonjë veprë penale, pranimin e fajit nga kryesit e veprës penale në shqyrtimin gjyqësor si dhe zotimin e tyre në gjykatë se në të ardhmen vepra të tilla nuk do të përsëriten, njëherit gjykata vlerësoi edhe sjelljen e kryesve pas kryerjes së veprës penale të cilët janë penduar thellësisht për veprën e kryer, rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarve me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit, andaj gjykata i'u shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti secilit veç e veç, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse të akuzuarit nuk kryejn vepra tjera penale me bindje se dënimet e shqiptuar i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi kërkesën pronësoresh juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**P.nr.517/2018 të dt. 05.11.2019**

**Bashk.Profesional**  
**Feim Bytyqi**

**Gjyqtari**  
**Qemail Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.